



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 13.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkeses për ri-shqyrtim të datës **12.08.2025** të parashtruar nga operatori ekonomik **GOE MAJOR SH.A. & MEB L.L.C.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë”** me nr. prokurimi 206-25-1648-2-1-1, Nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e GOE MAJOR SH.A. & MEB L.L.C. e datës 12.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë”** me nr. prokurimi 206-25-1648-2-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 08.08.2025 të publikuar në platformën elektronike.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 08.08.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i Operatoreve Ekonomik MAJOR SH.A. & MEB L.L.C. ka parashtruar kerkese per rishqyrtim per AP me titull **“Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërishtë”** me nr. prokurimi 206-25-1648-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 13.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

I pa kënaqur me Njoftimin mbi rezultatin e tenderit (B58) dhe në pajtim me 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , parashtrojmë këtë Kërkesë për Rishqyrtim kundër;

- **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58)** te datës 08.08.2025, ku është propozuar për shpërbllim të kontratës operatorin ekonomik;” Defence Secyriti sh.p.k “ me vlere totale të tenderit prej 168,560.64 €

Dhe

- **Njoftimit për tenderues të eliminuar, njoftuar përmes Letrës standarde** për tenderues të eliminuar),

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. **Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:**

- Neni 1-Qëllimi
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit dhe

Në vazhdim të kësaj kërkesë për rishqyrtim do t’ i argumentojmë pretendimet tona ankimore lidhur me shkeljet e dispozitave të;

Të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 (këtu e tutje LPP),

Pretendimet Ankimore te OE ankues:

Neni 1-Qëllimi

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues me vendim e vet që të shpërblej me kontrate tenderin e OE; “Defence Security” sh.p.k me vlere totale prej 168,560.64 € ka bere shkelje te dispozitave te nenit 1, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 1. paragrafi 1 dhe 2 te këtij ligji,

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës

Bazuar në dispozitat e nenit 1 të LPP-së, AK është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren për qëllimin e realizimit të kontratës.

AK me iniciimin e këtij aktiviteti të prokurimit ka për qëllim që të realizoj kontratën për sigurimin e shërbimeve të sigurimit fizik në objektet Ministrisë së Shëndetësisë, në pajtim me Ligjin për sigurimin fizik të objekteve, si dhe mbrojtjen juridike të punonjësve të sigurimit, duke kërkuar nga OE se do të i përmbahen dispozitave të Ligjit në fuqi të punës, Ligjit mbi procedurat e Administratës tatimore, Ligjit për skemat e pensione në Kosovë si dhe ligjeve tjera të aplikueshme që kanë të bëjnë me pagën minimale.

Bazuar në çmimin e ofertuar nga operatori ekonomik i propozuar për shpërblim të kontratës si dhe kërkesat e AK-se të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 1 të LPP-së duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat e AK-se.

Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar që tenderin ta vlerësojë në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje të OE të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit si dhe Kriterin për dhënie të kontratës, si dhe bazuar në Vendimin e AK-se për shpërblim të kontratës, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë

kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender si dhe kriterit për dhënie të kontratës, të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik i cili është propozuar për shpërblyerje të kontratës i cili ka ofertuar me çmimin i cili nuk përbush kërkesat e AK-se të përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së si dhe në momentin kur e ka eliminuar Grupin e OE "KSF MAJOR SH.A&MEB LLC".

Shkelje të nenit 59 të LPP-së AK ka bërë në monumentin kur e ka eliminuar ofertën e Grupit të OE; "KSF MAJOR SH.A&MEB L.L.C. si të përgjegjshëm me arsyetimin si ne vijim:

Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-ne, KRPP sqaron se edhe në këtë rast mirësjelljet për shlyerjen borgjeve duhet të jete parar publikimit të njoftimit për kontratë. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jete gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të tilla paslyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontrate". Paneli Shqyrtues përmes platformës elektronike e-prokurimi verën se kjo procedurë është iniciuar me datën 19.03.2025 15:53, ndërsa marrëveshja e konzorciumit i cili sipas Deklaratës mbi formimin e grupit ka ofruar 0 % pjesëmarrje . MEB L.L.C me Administratën Tatimore është pas publikimit të NJK dhe DT (Data e marrëveshjes me ATK-ne me datën 01.04.2025).

Oferta juaj është e përgjegjshme, bazuar në faktin se anëtar i konzorciumit MEB L.L.C. me Vendim të OSHP-se nr. 212/25 nga data 19.06.2025 është në Listë të Zeze.

Grupi i OE i pa kënaqur kundër Vendimit të kundërligjshëm të OSHP-se, për diskualifikim (r vendimeve nr 212/25 dhe 40/25 të datës 19.06.2025) ka ushtruar në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Padi për anulim të Vendimit si dhe ka ushtruar Kërkesë për pezullimin e Vendimit të OSHP-se për diskualifikim duke pretenduar se OSHP ka bërë shkelje të LPP-se në kuptimin material, si duke aplikuar gabimisht Ligjin.

Prove; Kopja e Padisë dhe Kërkesës për pezullim të Vendimit për diskualifikim në Gjykatën Komerciale në Prishtinë kundër Vendimit nr 212/25 dhe kopjen e Padisë kundër Vendimit nr 40/25 të datës 18.06.2025.

Në vijim të kësaj kërkeje do të përpiqemi që t' argumentojmë pretendimet tona ankimore përkitazi me OE të propozuar për shpërblyerje të kontratës.

AK ka propozuar për ta shpërblyer me kontrate me supozimin se me çmimin e ofruar në vlerë prej 168,560.64 euro do të i mbulojë shpenzimet e pagesës së punëtorëve të sigurimit fizik në bazë të këtyre kriterëve;

Bazuar ne ofertën financiare te OE te propozuar për shpërblim te kontratës pretendojmë se OE për çmimin e ofertuar , për periudhën prej 36 muajve, pretendojmë se OE, nuk mund te i mbuloj te gjitha kërkesat qe burojnë nga Ligji i Punës në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës si dhe shkallen e inflacionit vjetor për vitin 2025 i cili është ne ngjitje për çdo vit fiskal, si dhe vendimin mbi pagën minimale i cili pritet te ndryshohet gjate vitit 2025 dhe Ligjet tjera te aplikueshme ne Kosove të cilat ne mënyrë me detale do te i përshkruajmë ne vijim.

Pretendojmë se çmimi i ofertuar nuk mbulon për periudhën prej 36 muajve ;

Pagën minimale bruto e cila aktualisht është 350 euro, se bashku me benefitet e ligjit, e qe pritet te ndryshohet brenda viti 2025, Kontributet, TVSH-ne dhe Fitimin e kompanisë. Bazuar ne legjislacionin dytësor te prokurimit i cili është i aplikueshëm (dhe i obligueshëm për AK) nga dhjetori i vitit 2024 (Manuali për specifikime e detyrueshme teknike) i cili përcakton, udhëzimet për hartimin e specifikimit teknik për shërbimet e sigurimit fizik si dhe procedurën e vlerësimit te tenderit sipas kriterëve te përcaktuara ne këtë Manual, pretendojmë se vlera e tenderit ne shume prej 168,560.64 euro për 36 muaj nuk i mbulon koston e kontratës dhe si e tillë është e pa ekzekutueshme.

N' rast se AK do te nënshkruante kontrate do te i rrezikonte punonjësit e shërbimit te sigurimit fizik ne mos realizimin e te drejtave ne bagën baze burto sipas Vendimit te Qeverisë se Kosovës e cila është 377.58 euro, si dhe do te rrezikonte mos realizmin e te drejtën ne pagesat shtese gjate natës e cila me Ligj te punës ua garanton shtesat prej 30%, pagesën për shërbime te sigurimit fizik gjate vikendeve dhe festave e 50% te pagës baze.

OE i propozuar për shpërblim te kontratës nuk ka ofruar dëshmi dokumentare për pagën bazë 377.58 euro bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore qe burojnë sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212.

AK gjate fazës se vlerësimit te tenderit është dashur qe te ekzaminoj Analizën financiare te "Defence Security " sh.p.k dhe te dhe te konstatoj se vlera e kontratës e specifikuar ne ofertën financiare e dorëzuar nga OE i propozuar për kontratë nuk është ne harmoni me kriteret e përcaktuara ne Manualin për specifikime teknike.

AK me rastin e vlerësimit të tenderit është dashur të ketë parasysh që pagesat e punëtorëve duhet të kalkulohen;

- për punonjësit te cilat kryejnë shërbimet e sigurimit fizik gjatë ditëve të punës, 8 orë (08.00-16.00) paga e plote bruto 377.58 euro.
- për punonjësit te cilët kryejnë shërbimet e sigurimi fizik gjatë natës, 12 orë (19:00-7:00) te kalkuloj pagën së bashku me shtesat.
- për punonjësit te cilat kryejnë shërbimet e sigurimit fizik pas përfundimit të orarit të punës dhe gjatë natës, 16 orë (16:00-8:00) shtesat prej 30% te pagës baze.
- për punonjësit te cilat kryejnë shërbimet e sigurimit fizik gjatë 24 orëve, për vikend dhe gjatë festave, 24 orë (nga 08:00-08:00), shtesat prej 50% te pagës baze.
- për punonjësit te cilat kryejnë shërbimet e sigurimit fizik gjatë 24 orëve, 24 orë(nga 08:00-08:00) te kalkuloj pagën së bashku me shtesat.

Në vijim do ta ofroj dëshmi dokumentare të analizës financiare të cilën e Autoriteti kontraktues është i obliguar te beje kalkulimin e shpenzimeve për ta trajtuar një OE si te përgjegjshëm ne kuptim te dispozitave te LPP-se dhe Ligjeve tjera te aplikueshme qe ndërliiden me objektin e kontratës;

1.Analiza financiare për pagën 350 euro neto-Orari zyrtar sipas vendimit te qeverise nr 02/218 i datës 28.08.2024 dhe ligjeve ne fuqi te punës.

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Sa duhet me qene oferta me kontributet e punëdhënësit
1	Paga Neto	350.00
2	Tatimi ne Page	8.70
3	Trusti pensional 5% i punëmarrësit	18.88
4	Paga Bruto	377.58
5	Gjithsejtë paga Bruto	377.58
6	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	18.88
7	Gjithsej kostoja për punëtor pa TVSH-ne	396.46
8	18% TVSH-ja	71.36
9	Gjithsej Kostoja për punëtor me TVSH-ne	467.82
10	Fitimi i kompanisë	
11	Çmimi pa TVSH një ore pune për një punëtor pjesëtuar për 176 ore pune.	1.99
12	18% TVSH-ja	0.30
13	Çmimi me TVSH për një ore pune	2.29
14	Total orët e orarit zyrtar	79.42
15	Total çmimi pa TVSH	181.87€

2.Analiza financiare per pagën 350 euro bruto-Oret e nates 30%

1	Paga Neto	350.00
2	Tatimi ne Page	8.70
3	Trusti pensional 5% punëmarrësi	18.88
4	Trusti pensional 5% punëdhënësi	18.88
5	Paga Bruto	396.46
6	Orët e natës 30%	118.94
7	Gjithsej paga bruto	515.40
8	Trusti pensional 5% i punedhenesit me oret e nates 30%	5.66
9	Trusti pensional 5% i punemaresit me oret e nates 30%	5.66
10	Tatimi ne page	
11	Gjithsej kostoja per punetor pa TVSH	526.72
12	18% TVSH-ja	94.81
13	Gjithsej kostoja per punetor me TVSH	621.53
14	Cmimi pa TVSH per nje ore pune per nje punetor pjestuar per 176 ore pune ne muaj	2.60
15	18% TVSH-ja	0.47
16	Cmimi me TVSH per nje ore pune	3.07
17	Total oret e orarit te nates	39.33
18	Total cmimi pa TVSH	120.74€

3.Analiza financiare për pagën 350 euro + vikendet 50%

1	Paga Neto	350.00
---	-----------	--------

2	Tatimi ne Page	8.70
3	Trusti pensional 5% punemaresi	18.88
4	Trusti pensional 5% punedhenesi	18.88
5	Paga Bruto	396.46
6	Oret e vikendeve 50%	198.20
7	Gjithsej paga bruto	594.66
8	Trusti pensional 5% i punedhenesit me orët e natës 30%	9.44
9	Trusti pensional 5% i punemaresit me orët e nates 30%	9.44
10	Fitimi i kompanisë për një punëtor ne muaj	
11	Tatimi ne page	
12	Gjithsej kostoja për punëtor pa TVSH	613.54
13	18% TVSH-ja	102.09
14	Gjithsej kostoja për punëtor me TVSH	723.98
15	Çmimi pa TVSH për një ore pune për një punëtor pjesëtuar për 176 ore pune ne muaj	3.00
16	18% TVSH-ja	0.54
17	Çmimi me TVSH për një ore pune	3.54
18	Total orët e orarit te vikendit	51.25
21	Totali për oraret e punës gjate vikendeve	181.42€

4.Analiza financiare për pagën 350 euro + festat 50%		
1	Paga Neto	350.00
2	Tatimi ne Page	8.70
3	Trusti pensional 5% punemaresi	18.88
4	Trusti pensional 5% punedhenesi	18.88
5	Paga Bruto	396.46
6	Oret e festive 50%	198.20
7	Gjithsej paga bruto	594.66
8	Trusti pensional 5% i punedhenesit me oret e nates 30%	9.44
9	Trusti pensional 5% i punemaresit me oret e nates 30%	9.44
10	Tatimi ne page	
11	Fitimi i kompanisë	
12	Gjithsej kostoja per punetor pa TVSH	613.54
13	18% TVSH-ja	102.09
14	Gjithsej kostoja per punetor me TVSH	723.98
15	Cmimi pa TVSH per nje ore pune per nje punetor pjestuar per 176 ore pune ne muaj	3.00
16	18% TVSH-ja	0.54
17	Cmimi me TVSH per nje ore pune	3.54
18	Total oret e orarit te festave	6.00
19	Total cmimi pa TVSH	21.24€
TOTALI I PERGJITHSHEM (Analiza 1+2+3+4)=		505.27€

Pushimi vjetor 1 punëtor ne muaj
Pune shtese për 1 punëtor ne muaj
Fitimi i kompanisë

13.33 euro
6.00 euro
1.00 euro

Bazuar ne faktet e lartpërmendura si dhe kushtet për pjesëmarrje dhe kualifikim te OE te përcaktuara ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se duke vlerësuar tenderin në kundërshtim me kushtet për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender si dhe ne kundërshtim me dispozitat e **Ligjit të Punës Nr.03 L-212, Nenit 57 te - Ligjin Nr. 08/L-142, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve qe Përcaktojnë Shumen e Beneficionit ne Lartësi te Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit te Pagës dhe Shkallet Tatimore ne te Ardhurat Personale Vjetore cili ka hy ne fuqi me 23.08.2024,dhe - Vendimin e Qeverise së Kosovës me pagën minimale Nr.02/218 te datës 28.08.2024**, andaj tenderuesit duhet te respektojnë Vendimin ne fjale qe ka te beje me pagën minimale dhe Ligjin e Punës i cili përcakton te gjitha marrëdhëniet ndaj te punësuarve”

Duke pasur parasysh këto fakte i propozoj Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që pas aplikimit të dispozitave të LPP-së, që kanë te bëjnë me nenin 59, dhe 40 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të marrë këtë;

VENDIM

- **TE APROVOJ**, Kërkesën për Rishqyrtim si të bazuar të parashtuar nga Grupi i OE; KSF MAJOR SH.A& MEB L.L.C,
- **TE ANULOJ**, Njoftimin mbi Vendimin e AK-se te datës 08.08.2025 mbi rezultatin e tenderit (B58) ku është propozuar për shpërblim te kontratës OE: “Defence Secyriti ” sh.p.k

TE KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM, dhe ri-vlerësimi të bëhet në pajtim me, Kriteret e përzgjedhjes, dhe kualifikimit te OE, të cilat janë të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit si dhe ne pajtim me LPP-ne, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik te vitit 2023 dhe Ligjin e Punës Nr.03 L-212, Ligjin Nr. 08/L-142, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve qe Përcaktojnë Shumen e Beneficionit ne Lartësi te Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit te Pagës dhe Shkallet Tatimore ne te Ardhurat Personale Vjetore cili ka hy ne fuqi me 23.08.2024,dhe - Vendimin e Qeverise së Kosovës me pagën minimale Nr.02/218 te datës 28.08.2024, .

- Mbetemi me shpresë se kërkesa e Grupit të OE; KSF MAJOR SH.A& MEB L.L.C , do të shqyrtohet, pozitivisht dhe nuk do te këtë nevojë te i drejtohem i OSHP, dhe organeve tjera shtetërore, administrative dhe gjyqësore.

Me nderime,

Lideri Grupit Anil DAMKA

Dëmet materiale sipas OE ankues:

Nuk eshte paraqitur ndonje vlere e demit.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE ankues:

E kemi shqyrtuar Kërkesa tuaj për rishqyrtim dhe konsiderojme se pretendimet e juaja ankimore janë të pa bazuara, duke marrë parasysh se AK ka vepruar drejte dhe në zbatim të vendimit të OSHP-se nr. 2025-0474.

Eshtë i pa bazuar pretendimi juaj ankimor për shkelje të nenit 1 të LPP-se, meqenëse çmimi i ofertes së rekomanduar DEFENCE SECURITY SH.P.K. është 168,560.64 € dhe krahasuar me çmimin e ofertes tuaj prej 168,249.60 €, është vetëm për 311.04 euro më e lartë dhe ky dallim është minor për një kontratë kornize në vlerë të tillë për 36 muaj.

Eshtë i pa bazuar pretendimi juaj ankimor për shkelje të nenit 56 të LPP-se, meqenëse AK ka bërë rivlerësimin e lëndës bazuar në vendimin e OSHP-se nr. 2025-0474, në të cilin vendim Paneli Shqyrtues i OSHP-se ka konstatuar se oferta juaj është e papërgjegjshme dhe lenda është kthyer në rivlerësim, me ç'rast është shpërblyer oferta e dytë me radhë sipas kriterit për dhenie Çmimi me i Lirë.

Andaj ju si OE nëse nuk pajtoheni me vendimin e OSHP-se nr. 2025-0474 keni pasur të drejtë që kete vendim ta kontestoni në Gjykatën Komerciale, ashtu siç edhe ceket në keshillen juridike:

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Eshtë i pa bazuar pretendimi juaj ankimor për shkelje të nenit 59 të LPP-se, meqenëse AK ka bërë rivlerësimin e lëndës bazuar në vendimin e OSHP-se nr. 2025-0474, në të cilin vendim Paneli Shqyrtues i OSHP-se ka konstatuar se oferta juaj është e papërgjegjshme, për shkak të Marrveshjes për Shlyerjen e borgjeve ndaj ATK-se nga anetari i konsorciumit tuaj MEB L.L.C. siç ceket në vendim:

Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontratë". Paneli Shqyrtues përmes platformës elektronike e-prokurimi vëren se kjo procedurë është inicuar me datën 19.03.2025 15:53, ndërsa marrveshja e konzorciumit i cili sipas Deklaratës mbi formimin e grupit ka ofrur 0 % pjesëmarrje. MEB L.L.C me Adminstratën Tatimore është pas publikimit të NJK dhe DT (Data e marrveshjes me ATK-në me datën 01.04.2025).

Ndërsa nuk mund të konsiderohet se nuk i përmbush kërkesat e AK-se çmimi i ofertes së rekomanduar (168,560.64 euro), përderisa është për 311.04 euro më e lartë se oferta juaj dhe njejtë sikur edhe ju ka të plotësuar deklaratat për plotësimin e kushteve të kërkuara nga AK.

Sa i përket Vendimit të OSHP-se nr. 212/25 me të cilin anëtar i konzorciumit MEB L.L.C. nga data 19.06.2025 është në Listë të Zezë, kjo është rrethane e re e ndodhur në fazën e ankimit në OSHP dhe është arsye shtese për eliminimin tuaj, ndërsa arsya e parë është Marrveshja për Shlyerjen e borgjeve ndaj ATK-se nga anetari i konsorciumit tuaj MEB L.L.C. siç ceket në vendimin e OSHP-se nr. 2025-0474.

Sa i perket kontestimi nga ana juaj ne Gjykate te vendimit te OSHP-se nr. 212/25 per MEB L.L.C. ne Liste te Zezë, eshte e drejte e juaja ligjore, por kjo nuk eshte relevante per aktivitetin ne kete faze, meqense ne si AK e marrim per baze vendimin e OSHP-se nr. 212/25 qe aktualisht eshte ne fuqi dhe nuk mund te bazohemi ne procedura kontestuese neper gjykata perderisa nuk ka nje vendim te formes se prere nga gjykata.

Si perfundim:

Ne kemi vepruar ne harmoni me LPP-ne, duke mos favorizuar apo diskriminuar asnje ofertues, por fillimisht u kemi shpallur fitues juve me oferten me te lire, ndersa pas ankeses dhe vendimit te OSHP-se nr. 2025-0474, lenda eshte rivleresuar dhe eshte shpallur fitues oferta e dyte per nga çmimi me i lirë.


AK-MSh aktualisht i mbulon sherbimet e sigurimit fizik me nje kontrate emergjente per tre muaj, e cila skadon me dt. 24.09.2025 andaj eshte ne interesin e AK qe sa me pare te lidhet kontrata e rregullt per 36 muaj dhe te permbyllet kontrata e negociuar.

Perkunder te drejtes se juaj per ankese, por ne rrethanat e lartcekura, duke marre parasysh vendimin e OSHP-se nr. 2025-0474 dhe domosdoshmerine qe sa me pare te lidhet kontrata e rregullt per 36 muaj dhe te permbyllet kontrata e negociuar, ankesen e juaj e konsiderojme plotesisht te pa bazuar dhe me efekt demtues per AK, sa i perket procedures se ketij aktiviteti dhe mbarevajtjen e sherbimeve te sigurimit fizik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit